

MINISTRI

Zj. Klajda Gjoshja lindi në Tiranë, më datë 28 Korrik 1983. Ajo është e martuar me z. Ardian Gjoni.

Znj. Gjoshja u diplomua në vitin 2006 me titullin Master, në degën Studime Europiane, në Universitetin e Reading, në Mbretërinë e Bashkuar.

Në vitin 2005 përfundoi studimet Bachelor, në degën Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Reading, në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjithashtu në vitin 2002, znj. Gjoshja përfundoi shkollën e mesme në nivelin e avancuar pranë Kolegjit Strode në Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Gjoshja ka shërbyer si Zëvendësministre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (2012 - 2013). Prej vitit 2012 ajo është Nënkryetare e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Kryetare e Forumit të Gruas të LSI-së dhe anëtare Kryesie e kësaj partie.

Znj. Gjoshja ka ushtruar disa funksione drejtuese në institucione të tjera si: Bashkia e Tiranës, Drejtoria Rajonale e Punësimit Tiranë dhe Agjensia Kombëtare e Turizmit.

Gjithashtu, znj. Klajda Gjoshja ka kryer disa trajnime dhe internshipe pranë disa organizmave si: Agjencia Ndërkombëtare e Bashkëpunimit Japonez, Parlamenti Evropian, pranë zyrës së znj. Doris Pack, Bruksel.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe në nivel mesatar gjuhën italiane.

Zv/Ministre

Znj. Erisa Xhixho u lind në Tiranë më 17 Maj të vitit 1985.

Në vitin 2008, Znj. Xhixho u diplomua në degën Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Në 2009 ajo mori titullin Avokat dhe në vitin 2011 u diplomua në master të nivelit të dytë "E drejte Kushtetuese e krahasuar dhe Evropiane" në Fakultetin e Drejtësisë. Në vitin 2012, Znj. Xhixho përfundoi studimet Pre Master në "University of Exeter", Londër. Gjithashtu në vitin 2014 ajo është diplomuar me studime master për politika ndërkombëtare publike në "Queen Mary, University of London". Znj. Xhixho ka marrë dhe titullin Doktor i Shkencave në Fakultetin e Drejtësisë.

Nga viti 2007-2011, Znj. Xhixho ka qenë Anëtare e Këshillit Bashkiak, Tiranë. Gjatë periudhës 2005-2012 ajo ka qenë Kryetare e Lëvizjes Rinore për Integrim dhe prej vitit 2012 është Kryetare e Komitetit Drejtues të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Prej vitit 2008 Znj. Erisa Xhixho është pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Në shtator të vitit 2014 Znj. Xhixho është emëruar Zv. Ministër i Integrimit Evropian.

Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze, italiane dhe atë franceze.

Zv/Ministre

Prof.Dr. Eralda (Methasani) Çani ka mbaruar studimet për drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (UT) në vitin 1996. Ka studiuar pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Leyden, Hollandë gjatë vitit 1995, dhe ka kryer studimet pasuniversitare LL.M. në të Drejtën e Krahasuar Kushtetuese në Universitetin e Neë York School, SHBA/CEU, Budapest, Hungari në vitin 1998. Studimet e doktoraturës në fushën e së drejtës publike i përfundoi në Universitetin e Tiranës në vitin 2008, në vitin 2011 mori titullin "*Profesor i Asociuar*", miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, dhe në shtator 2015 titullin akademik "*Profesor*", miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, në fushën e së drejtës.

Ka kryer një numër të madh trajnimesh profesionale, ka ndjekur Shkollën Shqiptare të Politikës, organizuar nga Këshilli i Evropës, Tiranë dhe ka marrë pjesë si pedagoge vizitore në Universitetin

George Eashington, Uashington D.C, SHBA gjatë vitit 2007. Gjatë vitit 2015 ishte pjesë e programit të vizitorëve ndërkombëtare me Departamentin Amerikan të Shtetit të SHBA.

Eksperienca e punës fillon në vitin 1996 pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Në vijim është angazhuar si këshilltare ligjore pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe eksperte për çështje të ndryshme ligjore pranë organizmave ndërkombëtare si UNDP, USAID, Bankë Botërore, si dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Prej vitit 1999 angazhohet si pedagoge me kohë të plotë pranë Fakultetit të Drejtësisë/UT, si dhe në Institutit të Studimeve Evropiane/UT, në nivelin bachelor, master dhe të doktoraturës në lëndë të ndryshme të së drejtës dhe prej vitit 2013 me kohë të pjesshme. Që prej vitit 2010 angazhohet si pedagoge e së drejtës administrative pranë Shkollës së Magjistraturës. Në tetor 2013 emërohet Këshilltare për të Drejtën Publike pranë Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe prej muajit mars 2016 është emëruar Zv. Ministre e Integrimit European.

Znj. Çani është bashkë-autore e *“Fjalorthit të parë shqip-anglisht-shqip për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri/Kosovë”*, autore dhe bashkë-autore e një sërë botimesh fushën e të drejtës administrative, kushtetuese, apo të drejtat e njeriut, si *“Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e RSH”*, *“Cikël leksionesh për të drejtën kushtetuese-administrative”*, *“Shteti i së Drejtës dhe Qeverisja Vendore në RSH”*, *“E Drejta administrative në vështrim krahasues”*, etj.